# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449999**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sondazhi në JOQ: 86% e shqiptarëve pro dorëheqjes së Erion Veliajt |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1392086.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 17:06:32 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 16 shtator 2026, 16:50:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 16 shtator 2026, 16:49:00 UTC → 16 shtator 2026, 16:51:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund ta gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `968ed39c23e6449fbbd85958fea2c4fa39d4b19cc71123e324c65b4b25e6fa05` |
| TEKSTI | `2caa293b71cd29f734b8fe184b4286c7dba71f053ad1d1e7ea652b33ccd09113` |
| PAMJA | `e38cff4129134cab4b7883491de1a3401368b3b9e1fa7f9652fec62283fe1086` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9a1d3381ef93528192c253f0965044ec59360c8c5f1c1848ad2e916ffa8f74c7` |
| E MËPARSHMJA | `1f722cf1e9e1bb4f9f0a0e5629a94b6f70354c7631a69ebc8aaaf53992e957c3` |
| RRËNJA MERKLE | `9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9a1d3381ef93528192c253f0965044ec59360c8c5f1c1848ad2e916ffa8f74c7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Sondazhi në JOQ: 86% e shqiptarëve pro dorëheqjes së Erion Veliajt

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 16.09.2026, 18:50

Share Share



Ditën e djeshme, pas vendimit të Gjykatës së Lartë për lënien në burg të kryebashkiakut Erion Veliaj, redaksia e JOQ Albania publikoi një sondazh ku la në dorë të qytetarëve nëse duhet të largohet nga posti. Përgjigjja ishte një uragan i vërtetë: 86% e shqiptarëve pra mijëra persona votuan me një "PO" të prerë, duke nxjerrë përfundimisht "kartonin e kuq" për njeriun që e ktheu Tiranën në pronë private.

Pasi dyert e qelisë u kyçën përfundimisht nga Gjykata e Lartë, ja cilat janë akuzat përvëluese që e zhytën Veliajn në fundin e tij politik:

**Korrupsion pasiv i funksionarit të lartë publik-** Veliaj dyshohet se ka përfituar favore dhe përfitime të parregullta në lidhje me funksionin e tij si kryetar i Bashkisë së Tiranës. Këto përfitime janë lidhur me marrëdhënie me subjekte private, kompani dhe persona që kanë pasur interesa në Bashkinë e Tiranës.

**Pastrimi i parave-** Një pjesë e hetimit lidhet me dyshimet se para me origjinë të paligjshme janë kaluar përmes transaksioneve, subjekteve apo formave të tjera financiare për t'u fshehur burimi i tyre.

**Mosdeklarim dhe deklarim i rremë i pasurisë-** Veliaj nuk ka deklaruar në mënyrë të plotë ose të saktë disa pasuri, të ardhura apo përfitime që sipas ligjit duhet të deklarohen nga një zyrtar i lartë.

**Shpërdorim detyre-** Gjatë ushtrimit të detyrës si kryetar bashkie, Veliaj ka kryer veprime ose ka marrë vendime që bien ndesh me detyrimet ligjore të një zyrtari publik.

**Lidhje me kompani dhe persona privatë-** Një pjesë e rëndësishme e hetimit të SPAK lidhet me pretendimin se persona ose kompani private kanë përfituar nga marrëdhëniet me Bashkinë e Tiranës dhe më pas kanë krijuar përfitime që sipas prokurorisë kanë shkuar te persona të lidhur me Veliajn.

Populli e dha verdiktin e tij: 86% e Tiranës dhe e gjithë Shqipërisë nuk e do më në krye të bashkisë! Çështja tashmë nuk është nëse Erion Veliaj është i fajshëm përballë SPAK-ut, por se sa orë i kanë mbetur pa firmosur dorëheqjen zyrtare nga qelia.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.